



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 8 të Udhëzimit administrativ nr. 01/2015, për transparencë në komuna, nenit 32, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391 dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më, 22.03.2018 miratoi këtë

V E N D I M PËR KONSULTA PARAPRAKE PUBLIKE

I.

Miratohet Vendimi për dërgimin e Rregullores për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale në komunën e Prishtinës, në konsulta paraprake publike.

II.

Komisioni lidhur me vendimin e cekur në pikën I, do të ofrojë informata të nevojshme për opinionin - qytetarët e interesuar, përmes formave të fushatave informative, kontakteve me grupe të interesit dhe palët e interesuara për t'i diskutuar propozimet.

III.

Konsultat paraprake publike për rregulloren e cekur në pikën I të këtij vendimi, do të zgjasin 15 ditë.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përgjegjëse.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-70162/18, më 23.03.2018

